

LIGJ
Nr. 54/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 29/2024,
“PËR BURIMET UJORE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 35 ndryshohet si më poshtë:

“35. “Ministri” është ministri i ministrisë përgjegjëse për burimet ujore.”.

2. Pas pikës 35 shtohet pika 35/1 me këtë përmbajtje:

“35/1. “Ministria” është ministria përgjegjëse për burimet ujore.”.

Neni 2

Në përmbajtjen e ligjit togfjalëshi “me propozim të Kryeministrit” zëvendësohet me togfjalëshin “me propozim të ministrit”.

Neni 3

Në nenin 6, pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:
“b/1) Ministria.”.

Neni 4

Në nenin 7, pika 1, shkronja “a” shfuqizohet.

Neni 5

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1
Ministria

Ministria, në cilësinë e autoritetit qendror politikëbërës në sektorin e ujërave, ushtron kompetencat e saj në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij:

a) duke përcaktuar vizionin, objektivat dhe orientimet strategjike të politikave, programeve dhe instrumenteve planifikuese për menaxhimin e integruar, të qëndrueshëm dhe të mbrojtur të burimeve ujore, në aspektin sasior dhe cilësor;

b) duke siguruar zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të sektorit të burimeve ujore nëpërmjet koordinimit ndërsektorial, harmonizimit të interesave të përdoruesve dhe aktorëve institucionalë, si dhe garantimit të përputhshmërisë me kuadrin rregullator në fuqi;

c) duke orientuar zhvillimin funksional të sektorit të ujërave, në mbështetje të rritjes ekonomike, përdorimit efikas të burimeve ujore dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës, në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Fjala e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit, që ka si mision menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore të tyre, duke nxitur konkurrencën në përdorimin e burimeve ujore dhe rritjen e rentabilitetit ekonomik sipas përcaktimeve të ministrisë.”.

2. Shkronjat “a” dhe “l” të pikës 2 ndryshohen si më poshtë:

“a) harton dhe zbaton politikën, strategjitë, programet dhe projektet, që synojnë menaxhimin e burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore, sipas përcaktimeve të ministrisë;

...

l) harton rregulloren e funksionimit të Këshillit të Basenit Lumor dhe ia propozon ministrit për miratim.”.

Neni 7

Në nenin 10 pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. “Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Basenit Lumor miratohet nga ministri.”.

Neni 8

Në nenin 14 në pikat 1 dhe 2 përpara togfjalëshit “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore” shtohet togfjalëshi “Ministria dhe”.

Neni 9

Në nenin 52 togfjalëshi “informon Këshillin e Ministrave” zëvendësohet me togfjalëshin “informon ministrinë”.

Neni 10

Në nenin 54 në pikën 1 përpara togfjalëshit “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore” shtohet togfjalëshi “Ministria dhe”.

Neni 11

Në fillim të nenit 96 përpara togfjalëshit “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore” shtohet togfjalëshi “Ministria dhe”.

Neni 12

Në nenin 103 në pikën 1 pas togfjalëshit “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore” shtohet togfjalëshi “nëpërmjet ministrisë”.

Neni 13

Në nenin 127 në pikën 4 fjalët “Këshilli/n i/e Ministrave” zëvendësohen me fjalën “ministra/ministrinë”.

Neni 14

Në nenin 136 në pikën 6 togfjalëshi “sipas pikës 3” zëvendësohet me togfjalëshin “sipas pikës 4”.

Neni 15

Në nenin 141 në fund të pikës 3 shtohet togfjalëshi “si dhe në rastet kur veprimtaria do të kryhet në një zonë që i kalon kufijtë e një baseni.”.

Neni 16

Në nenin 167 në pikat 1 dhe 2 togfjalëshi “Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” zëvendësohet me fjalën “ministrisë”.

Neni 17

Pas nenit 179 shtohet neni 179/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 179/1

Dispozitë kalimtare

Buxheti i miratuar për vitin 2026 për Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore deri në rishikimin e ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026” ekzekutohet në strukturën aktuale buxhetore në përputhje me rregullat e legjislacionit buxhetor në fuqi.”.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.5.2026.

Shpallur me dekretin nr. 357, datë 12.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.